

Emri i pacientit

Mjeku ose infermierja juaj rekomandojnë që ju të kujdeseni vetë

Infeksioni juaj	Zakonisht zgjat	Si ta trajtoni veten më mirë për këto infeksione, tani dhe herën tjetër	Kur duhet të merrni ndihmë: Kontakttoni klinikën e mjekut tuaj të përgjithshëm ose kontaktoni NHS 111 (në Angli), NHS 24 (në Skoci 111), ose NHS Direct (Në Uells 0845 4647)
<input type="checkbox"/> Infeksionet e veshit të mesëm	4 ditë	<ul style="list-style-type: none"> • Pushoni mirë. • Pini lëngje të mjaftueshme për të shmangur etjen. • Pyesni farmacistin tuaj që t'ju rekomandojë mjekime për t'ju ndihmuar me simptomat apo dhimbjen (ose të dyja). • Temperatura është një shenjë se trupi po e lufton infeksionin dhe zakonisht përmirësohet vetë në shumicën e rasteve. Mund të përdorni paracetamol (ose ibuprofen) nëse ju ose fëmija nuk ndiheni rehat si pasojë e temperaturës. • Gjëra të tjera që mund të bëni të sugjeruara nga mjeku ose infermierja: 	<p>1 deri 8 janë shenja të mundshme të një sëmundjeje të rëndë dhe duhet të kontrolloheni urgjentisht. Telefononi për këshilla, nëse nuk jeni të sigurt se sa urgjente janë simptomat.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nëse keni dhimbje të forta koke dhe të vjella. 2. Nëse lëkura juaj është shumë e ftohtë ose ka një ngjyrë të çuditshme, ose ju dalin urtikarie të pazakonta. 3. Nëse ndiheni të turbullt ose e folura është e paqartë ose jeni shumë të përgjumur. 4. Nëse keni vështirësi në frymëmarrje. Shenjat mund të përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> o frymëmarrje të shpejtë o nxirrje rreth buzëve dhe e lëkurës poshtë gojës o Lëkura ndërmjet dhe sipër brinjëve thithet ose tërhiqet brenda me çdo frymëmarrje. 5. Nëse keni dhimbje në kraharor. 6. Nëse keni vështirësi në të gëlltitur ose ju dalin jargë. 7. Nëse kur kolliteni ju del gjak. 8. Nëse ndiheni më shumë më keq. <p>Shenja më pak serioze që zakonisht mund të presin deri në takimin e ardhshëm të mundshëm me mjekun e përgjithshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 9. Nëse nuk po përmirësoheni deri në kohën e duhur në kolonën "zakonisht zgjat". 10. Te fëmijët me infeksion të veshit të mesëm; nëse ju del lëng nga veshët ose nëse ju humbet dëgjimi. 11. Të tjera
<input type="checkbox"/> Dhimbje fyti	7 ditë		
<input type="checkbox"/> Ftohje e zakonshme	10 ditë		
<input type="checkbox"/> Sinoziti	18 ditë		
<input type="checkbox"/> Kolla ose bronkiti	21 ditë		
<input type="checkbox"/> Infeksion tjetër:ditë		

- Ftohjet, shumica e kollave, sinoziti, infeksionet e veshit, dhimbjet e fytit dhe infeksionet e tjera shpesh përmirësohen pa antibiotikë, pasi trupi juaj mund t'i luftojë zakonisht vetë këto infeksione.
- Sa më shumë që t'i përdorim antibiotikët, aq më e madhe është mundësia që bakteriet të rezistojnë kundër tyre, ndaj ato nuk funksionojnë më mbi infeksionet tuaja.
- Antibiotikët mund të shkaktojnë efekte anësore siç janë puçrrat, myku, dhimbje stomaku, diarre, reaksionet ndaj dritës së diellit, simptoma të tjera, ose të vjella, nëse pini alkool me metronidazole.

WORKING
together

To deliver your NHS
for our communities

Trajtimi i infeksionit tuaj



Mos ia jepni askujt tjetër antibiotikët tuaj dhe kthejini gjithnjë te një farmaci antibiotikët e papërdorur, që të asgjësohen në mënyrë të sigurt.



Kjo fletëpalosje është hartuar në bashkëpunim me këto shoqata profesionale.

